



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.80/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Shukri Sylejmani, kryesues, Ymer Hoxha dhe Ferit Osmani, anëtarë duke vendosur përkitazi me ankesat e Lëvizja Vetëvendosja (LVV), dega në Ferizaj, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak se ka pas më pak fletëvotime se sa votues në listat e votuesve, në seancën e panelit të mbajtur me 30.04.2012, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen si te pabazuara ankesat e Lëvizjes Vetëvendosja (LVV), dega në Ferizaj: Anr.80, Anr.81, Anr.82, Anr.85, Anr.88 dhe Anr.91.

A r s y e t i m

PZAP, më datë 29.04.2012 ka pranuar 6 (gjashtë) ankesa: Anr.80, Anr.81, Anr.82, Anr.85, Anr.88, Anr.91 nga Lëvizjes Vetëvendosja (LVV), dega në Ferizaj me te cilat pretendohet se në Vendvotimet – VV, si ne vijim ka pas më pak fletëvotime se sa votues në listë të votuesve.

- Sipas ankesës Anr. 80, pretendohet se në shkollën “Dëshmoret e Koshares” në fshatin Koshare - Ferizaj në VV 2515D/01R, kanë qenë 800 fletëvotime ndërsa në listën e votuesve kanë qenë 824 votues, në shkollën “Ali Hadri” në fshatin Mirash - Ferizaj, në VV 2516D/02R, kanë qenë 650 fletëvotime ndërsa në listën e votuesve kanë qenë 667 votues, në shkollën “Përparimi” të fshatit Lloshkobare - Ferizaj, në VV 2523D/03R, kanë qenë 850 fletëvotime ndërsa në listën e votuesve kanë qenë 864 votues.
- Sipas ankesës Anr. 81, pretendohet se në shkollën “Ahmet Hoxha” në Ferizaj, në VV 2501Y/03R, kanë qenë 850 fletëvotime ndërsa ne listën e votuesve kanë qenë 853 votues dhe në VV 2501Y/06R, kanë qenë 850 fletëvotime ndërsa ne listën e votuesve kanë qenë 871 votues.
- Sipas ankesës Anr. 82, pretendohet se në shkollën e Gjimnazit në Ferizaj, në VV 2502D/01R, kanë qenë 700 fletëvotime ndërsa në listën e votuesve kanë qenë 715 votues, në VV 2502D/04R, kanë qenë 610 fletëvotime ndërsa në listën e votuesve kanë qenë 623 votues, në VV 2502D/06R, kanë qenë 600 fletëvotime ndërsa në listën e votuesve kanë qenë 620 votues dhe në VV

2502D/07R, kanë qenë 600 fletëvotime ndërsa në listën e votuesve kanë qenë 618 votues.

- Sipas ankesës Anr. 85, pretendohet se në shkollën “Gjon Sereçi” në Ferizaj, në VV 2502X/02R, kanë qenë 650 fletëvotime ndërsa në listën e votuesve kanë qenë 671 votues, në VV 2502X/04R, kanë qenë 600 fletëvotime ndërsa në listën e votuesve kanë qenë 615 votues, në VV 2502X/06R, kanë qenë 650 fletëvotime ndërsa në listën e votuesve kanë qenë 652 votues, në VV 2502X/07R, kanë qenë 700 fletëvotime ndërsa në listën e votuesve kanë qenë 702 votues dhe në VV 2502X/08R kanë qenë 700 fletëvotime.
- Sipas ankesës Anr. 88, pretendohet se në shkollën “Pjetër Bogdani” në Ferizaj, në VV 2501X/01R, kanë qenë 850 fletëvotime ndërsa në listën e votuesve kanë qenë 858 votues, dhe në VV 2501X/04R, kanë qenë 850 fletëvotime ndërsa në listën e votuesve kanë qenë 864 votues.
- Sipas ankesës Anr. 91, pretendohet se në shkollën “Jeta e Re” në fshatin Greme - Ferizaj, në VV 2507D/01R, kanë qenë 750 fletëvotime ndërsa në listën e votuesve kanë qenë 766 votues dhe në VV 2507D/03R, kanë qenë 700 fletëvotime ndërsa në listën e votuesve kanë qenë 722 votues.

Parashtruesi i ankesave Lëvizja vetëvendosje pretendon se kjo përbën shkelje të nenit 87.4 të LZP-së.

Paneli i PZAP-it në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajton si një ankesë për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i në bazë të nenit 117.2 të Ligjit Nr. 03/L-256 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP-së ka shqyrtuar pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre dhe të provave tjera që gjenden në shkresa të lendes, duke konsideruar se nuk është e nevojshme caktimi i seancës dëgjimore ka gjetur se:

Ankesat janë të pabazuara.

Pretendimet nga parashtruesi i ankesave, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesa janë të pabazuara nga shkak se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për tu vërtetuar se ka ndodhur shkelja e pretenduar në ankesë, pasi që parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë provë që do ta argumenton se dallimi simbolik i numrit të Fletëvotimeve me votuesit në listën votuese në 18 (tetëmbëdhjetë) Vendvotimet e cekura, ka ndikuar në rezultatin e votimit.

PZAP-i përmes shkresës së protokolluar me nr. 97/2 të datës 30.04.2012 ka kërkuar nga Komisioni Qendror Zgjedhor - KQZ sqarime me qëllim të vërtetimit të pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesat e cituara në diapozitiv.

KQZ, përmes shkresës së protokolluar me nr. 459/2012 të datës 30.04.2012, Vendimit të KQZ-së të protokolluar nr. 392/2012 të datës 20.04.2012 me të cilin është bërë rumbullakësimi i numrit të fletëvotimeve për vendvotime dhe Tabelës së rumbullakësimit të fletëvotimeve në vendvotime, ka ofruar sqarimet e duhura nga të cilat shkresa vërtetohet se KQZ konformë nenit 87.4 të LZP-së ka shtypur 2001

fletëvotime me tepër ose 2.5 % me shume se numri i votuesve të regjistruar ne listën e votuesve ne Ferizaj.

Duke marrë parasysh sqarimin e lartpërmendur të KQZ-së i cili për PZAP-in është i pranueshëm dhe i arsyeshëm, si dhe faktin se edhe nga pretendimet ankimore në fjalë nuk rezulton se me rumbullaksimimin e numrit të fletëvotimeve të ofruara në vendvotime, ndonjë votues nuk ka mundur të votoj, apo se me këtë veprim votuesve ju është mohuar e drejta për të votuar e paraparë me nenin 5 dhe 89 paragrafi 2 i LZP-së, rezulton se pretendimet ankimore në këtë drejtim janë në tërësi të pabazuara. Prandaj për këto arsye, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, PZAP-i, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 80/2012 më datën 30.04.2012

**Kryesuesi i Panelit
Shukri Sylejmani**

